

# Ditë studimi/seminar



---

**BASSE-NORMANDIE MACÉDOINE**

---

## Më 19 shtator 2009, Shtypi i Maqedonisë dhe Shtypi Ballkanik kanë organizuar ditë studimi me temë « Çfarë pozite të ketë informata lokale në shtypin kombëtar në Maqedoni? »

Kjo ditë studimi ishte përbërë me një debat (12h-14h), mandej me një atelie praktike (14-30-16h30) mbi pyetjen se si të mbrohet informata lokale nga shtypi kombëtar në Maqedoni. Bëheshte fjalë për sensibilizimin e nevojave të informimit lokal dhe të indentifikimit të nevojave eventuale në fushën e trajnimit lidhur me koresponduesit lokal.

Për përgatitjen e këtij debati, *Shtypi i Maqedonisë*ka realizuar një studim preliminar duke treguar dendesinë dhe temat e trajtuara nga informimi lokal në shtypin kombëtar në Maqedoni. Ky studim pikërisht i ka lejuar ndërmjetësuesit të furnizojnë pjesëmarrësit me elemente shërbyese për diskutimin.



**Elena Kostovska, Viktorio Jakovlevski, Gabrielle Naudé (© photo : Julie Quetier)**

Ndërmjetësuesit i këmbimeve ishte Viktorio Jakovlevski, i *shoqatës së gazetarëve të Maqedonisë*(Zdruzenie na novinarite na Makedonija, <http://www.znm.org.mk/>). Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë numërojnë 600 anëtarë aktiv. Të bazuar në Shkup, ajo disponon gjithashtu 6 qendra rajonale, në Kumanovë, Tetovë, Shtip, Ohër, Manastir dhe Strumicë, dhe grumbullon korespondent të bazuar në terësinë e teritorit.

### 1) Debat (12h14h): « Çfarë pozite të ketë informata lokale në shtypin kombëtar në Maqedoni ? »

**Pjesëmarrësit:** Gazetarët korespondent lokal të shtypit kombëtar, anëtarët e redaksionit të shtypit kombëtar, gazetarë të shtypit lokal, përfaqësues të komunave, gazetar nga Normandia e Poshtme.

Ky debat ka grumbulluar dhjetë pjesëmarrës , në klubin e gazetarëve(Klub na novinari), salla e cila gjendet në Shkup ( qendër për ardhjen e të gjithë pjesëmarrësve):

Një gazetar nga redaksioni i të përditshmes kombëtare:

- ▶ Një përgjegjës i informatave rajonale të *Dnevnik* në shkup

Tre korespondent lokal të gazetave kryesore kombëtare, që vijnë nga rajone dhe komuna të ndryshme të Maqedonisë,

- ▶ Z.Dimitar Petrevski Grumar, korespondent nga *Dnevnik* në Shtip
- ▶ Zon.Svetlana Darudova, korespondente nga *Dnevnik* në Tikvesh dhe Negotinë
- ▶ Zon.Snezana Dzorleva, korespondente nga *Nova Makedonija* në Strumicë

Një gazetar i një javore lokale:



**Arben Fetahi** (© photo : Julie Quetier)

- ▶ Z.Arben Fetahi, shef redaktor i *Monitor*(Gostivar,Tetovë)

Tre përfaqësues të autoriteteve lokale:

- ▶ Z.Kovalevski, Shërbimi i informimit dhe mediave, komuna e Ohrid
- ▶ zon.Milena Ristova Mihajlovska, Shërbimi i marrëdhënieve ndërkombëtare,Komuna e Shtipit
- ▶ Z.Ivan Bojadziski, Shërbimi i bashkëpunimit, Komuna e Shtipit (gazetar korespondent i mëparshëm gjatë 18 vite)



**Briac Trébert, Christian Bouzols** (© photo : Julie Quetier)

dy gazetar nga Normandia e Poshtme:

- ▶ Z.Christian Bouzols,shëf redaktor i *Gazetës la Manche,Ile-et-Vilain dhe Mayenne*
- ▶ Z.Briac Trébert, korespondent lokal nga *Aujourd'hui en France* dhe *La liberté*(Caen).

### **Një numër i madh të pyetjeve janë trajtuar:**

1. Si është trajtuar informata lokale nga shtypi kombëtar (sasia,kualiteti,pozicioni gjeografik)
2. A ka shtypi kombëtar një strategji në fushën e mbrojtjes së informimit lokal? Nëse ka,cilën?
3. Për çfarë shërben informimi lokal, a është e rëndësishme për lektorët?
4. Si komunikojnë komunat dhe si e shofin mbrojtjen e informimit lokal nga shtypi i shkruajtur?
5. Cilat janë pistat e reflektimit dhe aksionet për ardhmërinë e informimit lokal në Maqedoni?

### **2) Atelie me korespondentët lokal ( 14h30-16h30)**

**Pjesëmarrësit:** Gazetarët korespondentë lokal të shtypit kombëtar, gazetarët e shtypit lokal.

### **Konkluzioni:**

Vazhdimi i debatit dhe i atelies, konkluzione të përbashkëta janë formuluar , pikat kryesore që dalin nga veshtirësitë e gazetarëve lokal, maqedonas si ato norman ishin:

-Social: pagat dhe kushtet e punës të gazetarëve apo korespondent loka

-Mungesa e bashkëpunimit në mes korespondetëve

-Shumë pak mundësi këmbimi ndërkombëtar të hapur me korespondentët, lidhur me gazetarët e redaksionit kombëtar.

-Margjinalizimi i punës



(© photo : Julie Quetier)

Këto këmbime kanë bërë nxjerrjen e disa pikave të përbashkëta në mes ushtrimit e detyrës së gazetarëve për informim lokal në Normandinë e Poshtme dhe në Maqedoni, papritmëri për pjesëmarrësit të cilët mendonin që situata e tyre ishte më e dalluar.

Pistat të cilat do të shërbejnë për veprime të ardhshme do të jenë të formalizuara nga Shoqata e gazetarëve nga Maqedonia në konkluzione të përbashkëta.